REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 524/26 Dt. 03.11.2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), të Rregullores (QRK) nr. 06/2023 për Kompensimin për Udhëtime Zyrtare dhe Shpenzime të Përfaqësimit, si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, bazuar në ftesën e Kryetarit të Komunës Metropolitane të Izmirit të Republikës së Turqisë, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
Për lejimin e udhëtimit zyrtar

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i Levent Bus- drejtor i Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave, Ellsabah Xhurxhehallo-drejtor i Drejtorisë së Pronës dhe Çështjeve Ligjore, Rita Drini-Kabineti i Kryetarit të Komunës dhe Fatime Uka-zyrtare ligjore të Komunës së Prizrenit, për pjesëmarrje në eventin "Ditët e Kosovës në Izmir" që do të organizohet (mbahet) nga data 20 nëntor 2026 deri me 21 nëntor 2026, në Izmir të Republikës së Turqisë, kështu që, për këtë qëllim, lejohen mjetet e nevojshme financiare, për pagesë të shpenzimeve të udhëtimit, mëditjeve, si dhe të shpenzimeve të paparashikuara për të lartcekurit.

2. Nisja (shkuarja) zyrtare bëhet me datë 19 nëntor 2026, ndërsa kthimi me 22 nëntor 2026.

3. Shuma e lejuar, e përshkruar si në këtë Vendim, do të sigurohet nga buxheti i Komunës-pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit dhe mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.

4. Obligohen të lartcekurit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Të lartcekurve,
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Arkivës së Kryetarit.